



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me kandidaturat për anëtar dhe kryetar të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë ERE. *(komision përgjegjës)*
2. Seancë dëgjimore me grupet e interesit, lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31. 5. 2012 "Për peshkimin", të ndryshuar". *(komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Robert Bitri, Eglantina Gjermeni, Tatjana Nurçe, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Edmond Leka dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Lefter Koka Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Petrit Ahmeti – Kryetar i ERE-s

Agim Nashi -

Maksim Shuli -

Mynyr Sinanaj -

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë

Gjergj Luca – përfaqësues nga Konfederata e Prodhuesve të Peshkimit dhe
Akuakulturës

Helidon Rugia – përfaqësues nga Shoqata e Investitorëve të peshkimit Durrës

Besim Troplini – përfaqësues nga OMP-ja-ja Durrës

Mezan Mezani – përfaqësues nga OMP-ja Vlorë

Arian Cinari – përfaqësues nga OMP-ja Shkodër

Filip Paco – përfaqësues nga OMP-ja Nartë

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Fillojmë mbledhjen e komisionit. Në rendin e ditës sot kemi seancë dëgjimore me kandidatët për anëtar dhe kryetar të bordit të Entit Rregullator të Energjisë. Relator për këtë çështje është zoti Andrea Marto.

Fjala është për ju dhe më pas fillojmë me dëgjesat.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Relacion mbi kandidaturat e paraqitura nga ekipi përzgjedhës për kryetar dhe anëtar të bordit të ERE-s.

Meqenëse përfundon mandati i kryetarit dhe i një anëtari të Entit Rregullator të Energjisë, Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin nr. 43 të vitit 2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, duhet të plotësojë këto vakanca.

Për kryetar të bordit të ERE-s, ekipi përzgjedhës ka paraqitur sipas ligjit dy kandidatura: e para është ajo e kryetarit aktual zotit Petrit Ahmeti, kurse e dyta e zotit Agim Nashi.

Zoti Ahmeti, i cili kandidon për një mandat të dytë, ka përfunduar studimet në fakultetin e inxhinierisë elektrike në vitin 1980 dhe ka një karrierë mbi 30-vjeçare në fushën e energjisë. Ka punuar prej vitit 1981 në pozicione të ndryshme të rëndësishme të sektorit elektroenergjetik, ku nga më kryesoret vlen të përmendim detyrën e tanishme dhe ajo e drejtuesit të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, KESH sh.a.

Zoti Nashi ka përfunduar studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në vitin ‘70. Edhe zoti Nashi ka një karrierë mbi 30-vjeçare në fushën e energjisë duke punuar në pozicione të rëndësishme në këtë sektor, si pranë KESH. sh.a, drejtor i Drejtorisë së Energjisë në Ministrinë e Energjetikës, kryetar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, si dhe drejtor në këtë ent.

Meqenëse në kriteret e përcaktuara nga neni 11, pika 5\ a, të ligjit nr.43\2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike kërkohet një kandidat, i cili duhet të jetë person i shquar në fushën e energjisë, si dhe duhet të kenë të paktën 15 vjet eksperiencë pune në sektorin e energjisë, mendoj se të dyja këto kandidatura i plotësojnë këto kritere.

Për anëtar të bordit të ERE-s, ekipi përzgjedhës ka paraqitur sipas ligjit dy kandidatura. Duhet thënë se ky anëtar, të cilit i mbaron mandati, mbulon çështje që lidhen me rregullimin në sektorin e gazit natyror. Njëra kandidaturë është ajo e anëtarit aktual të bordit, zotit Maksim Shuli dhe tjetra është kandidatura e zotit Mynyr Sinanaj.

Zoti Shuli kandidon për një mandat të dytë në bordin e ERE-s. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Minierave, dega Inxhinieri e nxjerrjes dhe e përpunimit të naftës dhe gazit, në vitin '82.

Zoti Shuli është profesor i asociuar dhe ka përvojë të gjatë në fushën e gazit dhe të naftës. Ka punuar në institucione shkencore dhe, siç u tha më sipër, aktualisht është anëtar i bordit të ERE-s.

Zoti Sinanaj ka përfunduar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, dega inxhinieri e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës dhe gazit, në vitin 1992. Nga viti 1993 ka punuar pranë kompanisë Alpetrol sh.a si drejtor i qendrës së transportit të naftës dhe gazit Patos. Gjithashtu, ka punuar edhe pranë AKBN-së. Zoti Sinanaj ka një eksperiencë 22 vjeçare në fushën e naftës dhe gazit.

Meqenëse në kriteret e përcaktuara nga neni 11, pika 5\c, të ligjit nr.43\2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, kërkohet që kandidatët të kenë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në sektorin e hidrokarbureve dhe të jenë me profesion inxhinier në sektorin e naftës ose të gazit, mendoj se këto dy kandidatura i plotësojnë kriteret ligjore.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Marto!

Siç u tha, kemi dy kandidatura për kryetar të ERE-s dhe dy kandidatura për anëtar.

Fillojmë dëgjuesën me zotin Petrit Ahmeti.

Ju lutem të jeni sa më sintetik, sepse kemi vetëm treçerek ore kohë në dispozicion për të katërta dëgjesat.

Bëni një prezantim të shkurtër të punës suaj dhe të aplikimit për të vazhduar punën. Më pas do të vazhdojmë me pyetjet nga anëtarët e komisionit.

Petrit Ahmeti – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, ju uroj suksese në drejtimin e këtij komisioni të nderuar!

Paraprakisht mund të them se unë jam diplomuar për inxhinieri elektrike. Kam punuar kryesisht në sektorin elektroenergjetik. Kam mbajtur detyra të ndryshme duke filluar nga një inxhinier i thjeshtë, kryeinxhinier i ndërmarrjes elektrike të Tiranës, këshilltar i ministrit të Energjisë, këshilltar i Kryeministrit Meta për problemet e energjisë, kam drejtuar Korporatën Elektroenergjetike, kur ajo nuk kishte kryer procesin e ndarjes së aktiviteteve deri në projektin që u mbështet edhe nga donatorët dhe Banka Botërore për ndarjen e aktiviteteve të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare. Pse e theksoj këtë gjë? Ka qenë një nga hapat më të rëndësishëm në kuptimin e organizimit të sektorit elektroenergjetik, i cili pati rezultatet e veta, duke evidentuar dhe identifikuar përgjegjësitë dhe problematikat në çdo sektor dhe në çdo pjesë të sektorit elektroenergjetik, në atë të gjenerimit, shpërndarjes dhe transmetimit të energjisë elektrike.

Më pas kam mbajtur detyrën e këshilltarit të ministrit të Energjisë, ku jam ngarkuar me detyra të shumta si hartimin e strategjisë kombëtare të energjisë, duke drejtuar grupin e hartimit të strategjisë kombëtare të energjisë dhe detyra të ndryshme që lidheshin gjithmonë me sektorin e energjisë elektrike. Më vonë jam emëruar si anëtar i bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në atë kohë pa marrë ngarkesën e gazit natyror, kurse vitet e fundit kam qenë edhe kryetar i bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike dhe të Gazit natyror.

Natyrisht, në aktivitetin tim unë kam pasur edhe mjaft kualifikime të tjera, të cilat lidhen me kurse apo diploma të ndryshme të marra si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Pa u zgjatur në këto, aktualisht para disa muajve ne kemi bërë zgjedhjet midis vendeve të Mesdheut në të cilin unë kam rolin e zëvendëspresidentit të të gjithë rregullatorëve të vendeve të Mesdheut. Mund të them 2 fjalë në lidhje me këtë problematikë. Është një iniciativë e BE-së, ashtu siç ka qenë iniciativa e krijimit të Shoqërisë të Vendeve të Europës Juglindore, e cila ka funksionuar jashtëzakonisht mirë nën ombrellën e Komunitetit të Energjisë me qendër në Vjenë.

Po ashtu, zëvendëspresidenca ime lidhet edhe me Bashkimin e Vendeve të Mesdheut, e cila e ka aktualisht qendrën në Milano. Ne kemi të asociuar përfaqësuesit tanë aty. Më i rëndësishmi është efekti dhe rezultati i anëtarësimit të vendit tonë në këto organizata, që lidhet me përafrimin e legjislacionit tonë sekondar me legjislacionin e BE-së. Aktualisht, çdo vendim

që marrim, e kemi të dakordësuar me Sekretariatit të Energjisë me qendër në Vjenë dhe me sekretariatit të Bashkimit të Vendeve të Mesdheut me qendër në Milano. E them këtë se iniciativa e përafrimit të legjislacionit tonë sekondar me legjislacionin e BE-së është një detyrim ligjor i vendeve anëtare të Bashkimit të Vendeve të Mesdheut dhe, gjithashtu, edhe të Europës Juglindore.

Për sa i përket aktivitetit të ERE-s, ku unë kam drejtuar Bordin, si kryetar i tij për 4 vjetët e fundit, mund të them me kënaqësi se kemi pasur një rritje të nivelit profesional, sepse nuk është fjala për një ent rregullator, i cili thjesht zhvillon politikat e zhvillimit të sektorit energjetik në një vend, por në mënyrë të pavarur ai merr shumë vendime shumë të rëndësishme për tregun e energjisë elektrike në vend. Mund të them me kënaqësi, se pavarësia e ERE-s, e cila është relative, në 5 vjetët e fundit ka qenë shumë e qenësishme. Vendimet që merren janë shumë sinjifikative dhe e kanë ndihmuar shumë zhvillimin e tregut të energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror në Shqipëri. Praktikisht, roli i kryetarit, pa dashur ta vlerësoj apo ta mbivlerësoj, është drejtimi administrativ i institucionit të ERE-s dhe njëkohësisht harmonizimi i të gjitha ideve dhe risive, që mund të ketë nga diskutimet e anëtarëve të bordit në diskutimet që bëjmë, në lidhje me vendimet që marrim për tregun e energjisë elektrike. Natyrisht, çdo vendimmarrje, çdo hapësirë ligjore që ne kemi plotësohet me arsyetimet e ndryshme, që lidhen në radhë të parë me interesin e konsumatorëve.

Një rëndësi mjaft të madhe i kemi dhënë kohët e fundit edhe mbrojtjes së mjedisit, për të cilin ne marrim vendime. E them këtë, sepse natyrisht, në dialogun me kompanitë ne kemi pasur jo thjesht rezistenca, por debate të ndryshme në lidhje me legjislacionin për mbrojtjen e ambientit dhe njëkohësisht legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorëve. Duhet të dimë se kemi trashëguar një sistem në të cilin raporti mes kompanisë dhe konsumatorëve nuk ka qenë aq i thjeshtë. Ai ka qenë një raport diskriminues karshi konsumatorëve. Praktikisht, vendimet merreshin dhe miratoheshin nga një bord, pa u konsultuar me përfaqësuesit e konsumatorëve. Ndërkohë, asnjë vendim nuk merret tani nga anëtarët e bordit kryesisht për sa u përket çmimeve pa u konsultuar me shoqatat apo me shtresat e interesuara për vendimet e çmimeve të familjarëve.

Një element mjaft i rëndësishëm që unë dua të theksoj, duke pasur parasysh edhe kohën relativisht të shkurtër, është edhe liberalizimi i tregut të energjisë elektrike për të cilin ne po

punojmë për hartimin e legjislacionit tonë sekondar, i cili ka në thelb krijimin e mundësisë për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit të mesëm (duke filluar nga 6 -10-20 kilovolt), të dalin në treg të lirë. Kjo nuk është thjesht një iniciativë, por është një detyrim nga BE-ja për liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike. Natyrisht, kjo ka problemet e veta, por ne mendojmë se në 2-3 vjetët e fundit ka krijuar një lloj maturie, sidomos me konsumatorët e lidhur me energjinë 35 kilovolt, të cilët kanë detyrimin ligjor të largohen ose duhet të shkëputen nga furnizimi i kompanisë së shpërndarjes. Në rast se ata nuk gjejnë furnizuesin e tyre, do të furnizohen nga kompania e shpërndarjes, por me një çmim të diferencuar nga çmimi me të cilin operohet praktikisht në kompaninë e shpërndarjes.

Për sa i përket perspektivës, natyrisht ka shumë sfida. Ashtu siç ka sfida sektori, ka sfidat e veta edhe rregullatori, sepse ne nuk ndjekim thjesht zhvillimet e sektorit, por udhëheqim zhvillimet e tij. Natyrisht, ne jemi të detyruar t'i udhëheqim mbi bazën e miratimit të legjislacionit tonë sekondar për zhvillimin sa më normal si të tregut të energjisë elektrike, si atë të gazit natyror në Shqipëri.

Për sa i përket tregut gazit natyror, do të flisja shumë fjalë optimiste, por më mirë do t'ia lija ta zhvillonin 2 komisionerët, që pretendojnë për anëtarë të bordit, të cilët lidhen direkt me zhvillimin e sektorit të gazit natyror.

Me pak fjalë, mund të them se ne kemi miratuar një paketë shumë të rëndësishme ligjesh për zhvillimin e tregut të gazit natyror, duke bërë licencimin e kompanive, por edhe duke krijuar mundësinë e tregtimit të gazit natyror në Shqipëri.

Nuk dua të zgjatem më shumë me fjalën time. Ka shumë gjëra të tjera për të thënë për zhvillimin e sektorin, por duke respektuar afatet kohore dhe formatin me të cilin është ndërtuar ky takim.

Ju falënderoj!

Niko Peleshi – Zoto Baraj ka një pyetje.

Besnik Baraj- Në fakt, para se të flisnit për mjedisin më shkoi mendja t'ju bëja këtë pyetje, por ju e thatë dhe më vjen mirë që në fokus të punës suaj është edhe mbrojtja e mjedisit. A është në fokus të veprimtarisë suaj kur ngrihen vepra hidroenergjetike, që dëmtojnë rendë mjedisin dhe janë në konflikt me legjislacionin në fuqi, këtu kam parasysh HEC-et e ndryshme

që janë ndërtuar apo po ndërtohen, dhe sa është limiti juaj për të influencuar që këto të mos ndërtohen?

Niko Peleshi – Fjala për ju.

Petrit Ahmeti – Faleminderit, zoti Baraj!

Unë dua të theksoj se një nga kushtet që ne kemi vendosur për dhënien e licencës të hidrocentraleve është leja që duhet të marrin në institucionet që kanë lidhje me mbrojtjen e ujërave. Pse ndodh kjo? Lidhur me fenomenet që kanë ndodhur kohët e fundit dhe kanë nxjerrë në pah në mënyrë të detyrueshme edhe komunikimin më tërësor dhe më institucional në lidhje me rezervat ujore, të cilat përdoren për prodhimin e energjisë elektrike, ne kemi vënë një kusht që detyrimisht para se të japim licencën të ketë edhe një opinion nga drejtoritë përkatëse, që trajtojnë problemin e rezervave ujore në Shqipëri, që më parë nuk e kemi pasur, por ne po zhvillojmë praktika dhe do ta miratojmë në bord, duke e vendosur si një kusht të kërkesave të licencës. Pra, të ketë edhe një opinion nga institucionet kompetente për të dhënë këtë opinion në lidhje me përdorimin e rezervave ujore në çdo lloj burimi në Shqipëri.

Besnik Baraj – Nganjëherë qeveritë ose ministritë nuk operojnë konform ligjit, kjo për shkak të një lloj trysnie që mund të kenë, ndërsa ju duke qenë institucion i pavarur mund të luani një rol më protektiv në drejtim të mbrojtjes së mjedisit.

Në qoftë se ju e keni këtë në fokusin tuaj dhe të zhvillohet një mekanizëm ligjor që pa lejen tuaj të mos ndërtohet, unë do ta vlerësoja shumë. Nëse është e nevojshme mund të na thoni ne se çfarë mund të bëjmë ne si ligjvënës për t'ju dhënë këto attribute?

Petrit Ahmeti – Zoti Baraj, unë ju falënderoj për mënyrën sesi e trajtoni këtë çështje. Në fakt, mua nuk më tërheq marrja e përgjegjësisë dhe e peshës së institucionit. Ajo që po bëjmë ne është thjesht një iniciativë. Ajo për të cilën ne duhet të prononcohemi lidhur me këtë problematikë është vetëm se dhënia e licencës do të kushtëzohet edhe nga dhënia e së drejtës së përdorimit të këtyre ujërave nga institucionet përkatëse që kanë dijeninë dhe autoritetin për të mbrojtur. Është shpejt dhe rezervohem të jap një përgjigje të drejtpërdrejtë, por jam plotësisht i hapur për të diskutuar për ngarkesën që mund të ketë qeveria, e cila e di vetë se ku e merr dhe si e merr, por edhe ne si institucion ta trajtojmë këtë lloj problemi.

Unë dua t'ju them se ky element është në vëmendjen e punës së rregullatorit.

Faleminderit!

Niko Peleshi –Faleminderit, zoti Ahmeti!

Meqenëse nuk ka pyetje të tjera, vazhdojmë me dëgjesën tjetër të kandidaturës për kryetar të bordit të Entit Rregullator të Energjisë, që është zoti Agim Nashi.

Agim Nashi – Përshëndetje të gjithëve!

Unë mjaftohem me prezantimin e CV-së sime që bëri relatori dhe nuk dua të zgjatem më. Duke qenë se unë kam një kohë të gjatë që punoj për Entin Rregullator dua t’ju them se cilat janë pretendimet e mia për zhvillimin e punës. Duke qenë se ne jemi një ent i pavarur dhe struktura e energjisë elektrike përbëhet nga dy komponentë kryesorë, ku njëra pjesë është monopol dhe pjesa tjetër komerciale, ne po punojmë dhe jemi munduar që të dyja këto t’i dallojmë nëpërmjet të gjitha iniciativave komunitare, që sot janë të ndara në sektorë dhe ndarjen e pjesës komerciale nga pjesa e monopolit neutral duke fraksionuar sektorin nëpër...

Që në të kaluarën energjia elektrike dhe kompanitë tona kanë qenë të integruara vertikalisht. Kjo gjë bëhej vetëm nga një korporatë, ndërsa tani kjo po fraksionohet dhe për këtë arsye, duke qenë se në sektorin e energjisë elektrike po implementohet një reformë kontemporane europiane në harmoni me të gjitha direktivat komunitare, neve na është dhënë detyra, për të cilën duhet të fokusohemi më shumë, që të plotësojmë të gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor për t’i mbështetur këto iniciativa dhe këtë reformë. Si rezultat i kësaj reforme, deri tani reforma ka qenë e suksesshme, sektori po ecën drejt përmirësimeve të mëtejshme dhe kam besimin se edhe roli ynë si rregullator do të jetë i tillë që ta shtyjë më tej këtë reformë.

Nga ana tjetër, ne do të fokusohemi pak më shumë në detaje për të rritur shkallën e monitorimit të sektorit, e cila është një gjë shumë e rëndësishme, qoftë monitorimit si treg, qoftë edhe monitorimit për dy kompanitë e tjera, që janë monopol shpërndarjeje dhe transmetimi. Ndërkohë, po punojmë për të implementuar kushtet e tjera për furnizimin dhe realizimin e cilësisë së energjisë elektrike, jo vetëm nga ana sasiore, por edhe cilësore. Pra, duke u fokusuar këtu, mendoj se do të arrijmë suksese dhe kontribute ende më të mëdha për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike.

Niko Peleshi – A ka pyetje?

Faleminderit, për prezantimin!

Atëherë, vazhdojmë me dëgjesën e zotit Maksim Shuli dhe më pas me dëgjesën e zotit Myhyr Sinanaj, që kanë paraqitur kandidaturën për anëtarë të bordit të komisioneve të ERE-s.

Urdhëroni!

Maksim Shuli – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zotërinj deputetë!

Nuk do të flas për CV-në time, pasi ju e keni atë përpara. Kam një jetë që punoj në sektorin e gazit natyror, me gjithë përvojën time, me përjashtim të 4 vjetëve që kam qenë deputet në sallën tuaj të nderuar.

Gjatë këtyre 5 vjetëve që kam pasur mandatin e komisionerit të gazit, ne kemi bërë detyra të mëdha, kryesisht kemi implementuar paketën e tretë të energjisë pa implementuar më parë paketën e parë dhe të dytë. Kjo ishte një arritje, sepse pa implementimin e paketës së tretë, nuk do të kishim projektin TAP në Shqipëri. Faktikisht, kemi miratuar një sërë rregulloresh, kodesh, tarifash, një sërë aktesh nënligjore që të bënim certifikimin e projektit TAP. Para një jave ne bëmë licencimin e projektit TAP. Pra, që të bësh certifikimin e projektit TAP, duhet të kesh unison të të gjithë legjislacionit bazë të direktivës 2009 EU-s.

Njëkohësisht, kemi bërë certifikimin e Albgazit dhe licencimin, si operator i transmetimit dhe operator i shpërndarjes së Albgazit. Kjo ka bërë të mundur që për një kohë të shkurtër Albgazi të krijojë një ndërmarrje të përbashkët me Snam-in, i cili brenda një muaji Enti Rregullator i Shqipërisë, i Greqisë dhe i Italisë do të bëjnë të mundur nënshkrimin e marrëveshjes së mirëmbajtjes me projektin TAP. Tashmë e dimë që projekti TAP është projekt i një rëndësie të veçantë, një projektstrategji dhe ne po përgatitemi që, nëpërmjet këtij projekti, ku do të të fillojë operimi në vitin 2020, do të bëjmë të mundur përgatitjen e kushteve për zhvillimin e tregut të gazit.

Përballë këtyre akteve nënligjore që kemi bërë në rregullore dhe në kod, kemi bërë të mundur që brenda një kohe të shkurtër të gjitha aktet nënligjore që kur të fillojë operimi në vitin të 2020 projekti TAP të jetë efektiv në vendin tonë.

Në lidhje me kandidaturën time, mendoj se objektivi i punës sonë është se tashmë qeveria e ka një strategji të energjisë të miratuar me vendim qeverie. Në vitin 2030 duhet të bëjmë diversifikimin e burimeve të energjisë, nga ku 20% do të jetë përbërja e energjisë së gazit.

Tashmë qeveria ka miratuar masterplanin e gazit dhe janë identifikuar 5 projekte prioritare: projekti i tubacionit nga Fieri deri në Vlorë, projekti nga Ballshi në Gjirokastrë,

projekti nga Fieri në drejtim të Tiranës-Durrësit dhe projekti nga Elbasani në Korçë. Këto janë detyra që duhet t'i plotësojmë me të gjitha aktet rregullatore. Detyra e qeverisë është të sigurojë investimet dhe zhvillojë infrastrukturën, kurse detyra jonë si rregullatorë është që të bëjmë të gjitha aktet e nevojshme nëligjore për ta implementuar atë.

Njëkohësisht, po përgatitemi me anë të akteve nënligjore edhe për projektin IAP, projekti IAP është një projekt, i cili do të fillojë në Fier dhe do të përfundojë në Kroaci. Faktikisht në territorin tonë ai do të jetë si një magjistrat kryesor, kjo do të bëjë që të gjitha qytetet e Shqipërisë të gazifikohen me një magjistrat kryesor deri në kufi me Malin e Zi. Ndërkohë, projektet janë të tilla dhe tashmë po bëhet studimi i parafizibilitetit për gazin Shqipëri-Kosovë dhe Shqipëri-Mali i Zi. Njëkohësisht, janë fituar dy projekte për të bërë projektfizibilitetin e *storage* të gazit në kripërat e Dumresë, i cili do të na krijojë hapësira të mëdha për të ardhmen, sepse jemi i vetmi vend që mund të krijojmë një hap të tillë në vendin tonë. Ky hap do të krijohet, sepse ndërthuret projekti TAP dhe projekti IAP. Njëkohësisht, *storage* që është i vetmi vend që mund ta përdorim për të gjithë territorin shqiptar, pra këtu kam parasysh Greqinë, Maqedoninë e Veriut, Kosovën, Shqipërinë, Malin e Zi deri në Kroaci, sepse, nëse sot bëhet ruajtja nëntokësore e gazit të lëngshëm që ka risk dhe kosto, *storage* që mund të bëjmë ne, ose ruajtjet nëntokësore të gazit që mund të bëjmë në masivin kripor të Dumresë, është me shpenzimet 3-4 herë më të lehta dhe, si të thuash, e bën vendin tonë shumë të rëndësishëm në këtë nyje të ndërthurjes së këtyre tubacioneve. Detyra e qeverisë është të ndërtojë infrastrukturën dhe ta mbështesë me akte nënligjore.

Po flas pak për projektin e TAP-it. Deri tani ka mbaruar 84%, nga 215 kilometra që është tubacioni në tokë, për 214 kilometra është shtrirë linja e tubacionit. Në 83% të tubacionit është rikthyer toka në gjendjen e mëparshme. Janë punësuar 3800 punonjës, nga të cilët 80% janë punonjës shqiptarë. Ka rreth dy muaj që ka filluar ndërtimi i tubacionit në det. Në mars fillojnë punimet intensive. Brenda vitit 2020 do të përfundojë tubacioni nën det. Thellësia e detit është 820 metra dhe do të kalojë në Otranto. Presioni do të jetë 150 ballë. Tubacioni do të shtrihet nën det. Gjatësia e tubacionit është 105 kilometër, nga Semani deri në brigjet e Barit. Maksimumi i thellësisë është 820 metra. Stacioni i kompresorëve ndodhet në Fier dhe atje ka mbaruar 78%. 90% e stacionit të matjes në Bilisht ka mbaruar. Kanë mbaruar të gjitha sistemet e

bllokimit, sepse në të ardhmen mund të ndodhin edhe defekte. Edhe ne i kemi mbaruar të gjitha aktet tona rregullatore dhe jemi unison me rregullatorin grek dhe atë italian.

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Bici.

Dritan Bici – E dëgjova me vëmendje këtë punën e gazsjellësit të TAP-it. Nuk e di a duhet t'jua bëj juve këtë pyetje. Shqipëria po bëhet një vend transiti për gazin, njëkohësisht edhe do ta përdorim këtë gaz. A detyrohen firmat e ndërtimit që ne ndërtimet e reja që do të bëjnë të kenë të instaluar edhe impiantet e gazit? Do të jetë shumë problem hapja e tubacioneve nëpër qytete. Të mos jetë problem që një pallat të ketë edhe rrjetin e tubacioneve të gazit për familjet.

Faleminderit!

Maksim Shuli – Pyetja është shumë e mirë. Faktikisht, këto janë probleme të rregullatorit dhe të qeverisë. Qeveria faktikisht ka pesë projektet që përmenda pak më parë. Investimi për infrastrukturën e gazit përdoret për industri, për familjarë, për bujqësi etj., mund të shkojë rreth 3 miliardë, pra investime për zhvillimin e të gjithë infrastrukturës.

Pra, të fillojë që nga projektet e pallateve, pra të mos lejohet asnjë lloj pallati të ndërtohet pa rrjetin e gazit. Unë do të jap vetëm një shembull, në qoftë se sot kemi nevojë për 600 milionë metër kub gaz në vit, që është rreth 400 mijë tonë naftë, po ta konvertojmë, në vitin 2040 do të shkojmë në 2,8 miliardë. Kështu që jemi të detyruar që çdolloj projekti të bëhet me infrastrukturën e gazit, madje jemi të vonuar. Në qoftë se në vitin 2020 gazi do të vijë nga Azerbajxhani në Shqipëri, ne ende nuk jemi në gjendje ta përdorim atë, më përjashtim të TEC-it të Vlorës, i cili mund të rikthehet me pak investime. Ne nuk jemi në gjendje ta përdorim atë në industri apo në familje.

Niko Peleshi – Sa është sasia e gazit që ne kemi kontraktuar, nëse kemi kontraktuar nga gazsjellësi TAP? Sa e kemi hapësirën? Ju me të drejtë thatë se ne nuk jemi gati ta përdorim gazin, sepse nuk kemi ngritur infrastrukturën qoftë industriale qoftë për përdorim shtëpiak. Në qoftë se do ta kishim mundësinë, sa është sasia që ne mund të shfrytëzojmë nga ky gazsjellës?

Maksim Shuli – Faktikisht, për gazin që do të vijë me tubacionin e TAP-it qeveria ka një marrëveshje 300 milionë metër kub gaz dhe 300 milionë i ka me Enel, rreth 600 milionë metër kub gaz. Kur të vijë, mund ta përdorim te nafta, në termocentral, pra që sot jemi në gjendje të përdorim 0,6 deri në 0,8, pra 600 deri në 800 milionë metër kub gaz. Në tetor të këtij

viti, me krijimin e Albgazit dhe me ndërmarrjen e përbashkët që është bërë me Snam-in (është pikërisht kjo marrëveshja që do të bëjë me TAP-in), do të rritet siguria e mirëmbajtjes së tubacionit. Vetë Albagazi, një nga kushtet që kemi plotësuar, është që në tetor të futet në *mark test*, pra të sigurojë kapacitete të tjera, sepse në tubacion kemi lënë dy pika hyrje-dalje, një në Kuçovë dhe një në Fier. Kjo do të thotë se pjesa e Kuçovës deri në Korçë është e lirë për t'u furnizuar me gaz. Njëkohësisht, nuk presim vetëm të marrim gaz nga TAP-i, por edhe të injektojmë gaz në TAP. Presim rezultatet e para të Shpiragut, edhe Kryeministri e ka përmendur këtë fakt dhe pas disa ditësh do të marrim rezultate. Pra, në të ardhmen ky lloj gazi fillimisht do të përdoret në Shqipëri dhe më pas me rritjen e sasive do të futet dhe do të injektohet edhe në rrjetin europian dhe atë rajonal.

Niko Peleshi – Ju thatë se ka vetëm dy pika daljeje, një në Fier dhe një në Kuçovë. Po në qoftë se ne do të kemi nevojë që ky gaz të përdoret në industri apo për përdorime shtëpiake në zona të tjera të Shqipërisë a është e mundur të krijohen pika të tjera daljeje? Për shembull, ne i kemi dhënë statusin e investitorit strategjik para disa muajsh nga Komiteti i Investimeve Strategjike një projekti kroato-austriak, në mos gabo, për ndërtimin e një TEC-i në zonën e Korçës, i cili është një investim prej rreth 300-400 milionë eurosh me aq sa mbaj mend, po aty nuk ka një pikë daljeje. A është e mundur që pikat e reja të daljes të hapen edhe kur gazsjellësi është operativ?

Maksim Shuli – Po, është e mundur. Para 2 javësh ne kemi pasur një takim me drejtuesit e TAP-it, pikërisht për këtë temë. Faktikisht, midis ministrisë dhe Entit Rregullator ka një korrespondencë së bashku me TAP-in, sepse për pikat e daljes miratohen 3 NRA-të. Pra, 3 entet rregullatore propozohen nga TAP-i dhe miratohen për 1 ditë, sepse e tillë është procedura. Faktikisht, ne e kemi lënë të hapur këtë pikë, pikën e tretë, atë të daljes në Korçë, pasi vazhdon ende diskutimi ndërmjet TAP-it dhe qeverisë, sigurisht jemi edhe ne brenda.

Gjithmonë, kur ka pika hyrjeje dhe daljeje duhet të ketë sasi gazi. Ne kemi diskutuar për 5 BSM që janë 5 miliardë me idenë që nga Fieri ne të shkojmë drejt Kroacisë, Malit të Zi, Kosovës dhe në vende të tjera në mënyrë në mënyrë që të bëhemi vend tranzit. E kemi lënë në Kuçovë, sepse aty duhen sasitë, sepse, po nuk u vlerësua sasia nuk bëhet, prandaj edhe me markuesin që do të bëhet tani, për këtë arsye kemi lënë një dritare hapur, në mënyrë që nëse kërkesa do të jetë e argumentuar nga qeveria, e cila i është dhënë TAP-it dhe po diskutohet, sa i

takon sasisë së gazit që do të përdoret. Pra, në qoftë se TEC-i është 300 mega, 100 mega i thonë 0,6 BSM, 600 milionë, kështu që i bie që ky TEC kërkon 600 milionë m³ gaz në vit, 300 ditë pune në vit.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk është problem kjo gjë, sepse gazi gjendet, por ideja është një marrëveshje midis qeverisë dhe TAP-it dhe ne ta miratojmë dhe ajo pikë të jetë...

Niko Peleshi – Po.

Petrit Ahmeti – Nuk dua të shtoj asgjë më shumë nga ato që tha zoti Shuli. Po të kthehemi dhe të shohim zhvillimin e projektit të gazsjellësit ose zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, ne kemi qenë shumë skeptikë në lidhje me përdorimin e gazit në momentin kur u bë miratimi për kalimin e gazsjellësit në Shqipëri. Në këtë aspekt është diskutuar vetëm problemi i TEC-it në Vlorë, i cili mund të përthithte një sasi relativisht të madhe.

Fatmirësisht, ky lloj zhvillimi ose trajtimi i problemit të gazit natyror në Shqipëri ka nxjerrë në pah interesa të tjera, të cilat janë edhe në sensin praktik më të afërta për t'u zhvilluar, por edhe një interesim nga ana e investorëve të huaj, siç është shembulli në Korçë, për të investuar praktikisht në këtë sektor të përdorimit të gazit.

Një pjesë tjetër e rëndësishme, të cilin e përmendi edhe zoti Shuli, por unë dua ta theksoj më shumë, është zhvillimi i linjës së gazit në drejtimin verior të Shqipërisë, sepse ka një interes dhe ka biseda konkrete që lidhen me Malin e Zi aq më tepër me Kosovën, të cilat janë perspektiva të hapura tashmë, por nesër mund të bëhen edhe biseda konkrete sa i takon investimit dhe zhvillimin e linjave të gazit natyror në Shqipëri.

Sa i takon përdorimit të gazit në Shqipëri, ka pasur interes nga ana e dy kompanive të huaja, një kompani turke dhe një kompani kroate, për të zhvilluar edhe rrjetin e përdorimit të shpërndarjes së gazit, por ende janë duke u zhvilluar bisedime dhe asgjë nuk është zyrtarizuar.

Niko Peleshi – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Vazhdojmë dëgjuesën me zotin Mynyr Sinanaj, i cili kandidon për anëtar të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Mynyr Sinanaj – Faleminderit!

I nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Nuk do të zgjatem sa i takon CV sime, pasi të gjithë ju e keni përpara në tavolinë. Unë kam një eksperiencë 25-vjeçare në fushën e hidrokarbureve, 20 vjet kam punuar në Albpetrol, duke filluar si inxhinier kantieri deri në drejtues filialesh për prodhimin dhe transportin e naftës dhe të gazit. Aktualisht, jam në Drejtorinë e Hidrokarbureve në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, ku merrem me ndjekjen e licencë-marrëveshjeve dhe marrëveshjen e hidrokarbureve në fushën e prodhimit. Platforma që po paraqes para jush për të konkurruar për anëtar të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, është e bazuar në këto problematika:

- ndërtimi dhe vënia në punë e projektit TAP, si një projekt shumë i rëndësishëm për Shqipërinë dhe për gjithë rajonin, i cili lidh Ajzerbaxhanin me Europën Perëndimore;

- kontrolli rigoroz ndaj kompanive që janë në marrëdhënie hidrokarburesh me Albpetrolin dhe AKBN në vendin tonë si për kompanitë koncesionare që kryejnë operacione hidrokarburesh në fushën e prodhimit dhe ato të kërkimit. Në shumë raste kemi pasur edhe heqje të marrëveshjeve të hidrokarbureve, si dhe prishje të marrëveshjeve koncesionare;

- njehsimi i punës së institucionit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe me direktivat europiane si ligji “Për energjinë elektrike”, ligji “Për gazin natyror”, ligji “Për eficiencën e energjisë”, ligji “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, modeli i tregut të energjisë elektrike, si dhe shumë dokumente të tjera të rëndësishme;

- gazifikimi i sektorit energjetik.

Duhet shfrytëzuar në maksimum projekti TAP dhe IAP dhe lidhja e mundshme e Shqipërisë me Kosovën dhe me linjën e gazit natyror.

Krijimin e një standardi për zhvillimin e sektorit të naftës dhe të gazit në rajon që përcakton në mënyrë të përshtatshëm vendin tonë;

Përdorimin e gazit natyror kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë së arritjes në nivel sa më të lartë;

Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi i shoqërisë Albgaaz.Sh.a si dhe bashkëpunimi i saj me partnerë strategjikë dhe me eksperiencë në sektorin e gazit për gazifikimin e ekonomisë shqiptare;

Skenari i promovimit të gazit natyror të depërtojë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe kërkesës rezidenciale;

Shërbime, industri, transport dhe bujqësi;

Gjenerimi i energjisë elektrike;

Skenari i promovimit të gazit natyror për të reduktuar kërkesat e reja të gjenerimit, krahasuar me skenarin bazë, sepse zëvendëson hidroenergjinë e përdorur për ngrohje në ambientet me gaz natyror;

Vendimi i Shqipërisë për të aplikuar për anëtarësimin në Bashkimin Europian duhet të shoqërohet edhe me reforma institucionale për të përmirësuar menaxhimin e nevojshëm të sektorit të naftës dhe të gazit në Shqipëri dhe duhet të jetë në përputhje me direktivat e BE-së;

Konsolidimi i kuadrit ligjor për sektorin e gazit do të krijojë një bazë solide për mbështetjen e politikave dhe projekteve për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, si dhe integrimi i tij rajonal në përputhje me standardet e BE-së, proces që është i nxitur edhe nga ardhja e gazit natyror nëpërmjet gazsjellësit TAP që kalon nga Shqipëria për në Itali.

Sfidat për të ardhmen:

Në strategjinë e energjisë është si objektivi diversifikimi i burimeve të energjisë;

Gazifikimi i Shqipërisë 20 % deri në vitin 2030;

Zhvillimi i infrastrukturës së gazit në vendin tonë;

Përgatitja për tregun e gazit në vitin 2020, kur fillon ardhja e gazit nga TAP-i;

Integrimi i rrjetit tonë në atë rajonal, Malin e Zi, Maqedoni dhe në Kosovë.

Dy projektet kryesore prioritare për Shqipërinë janë:

Projekti i gazsjellësit TAP, që po zhvillohet nga një konsorcium aksionesh që këto kanë ndryshuar, i cili do të sjellë gazin nga Kaspiku dhe Lindja e Mesme në vendet europiane. Gazsjellësi ka një gjatësi 800 kilometër dhe një kapacitet transportues 10 miliardë normal metër kub, me mundësi për ta rritur deri në 20 miliardë normal metër kub dhe do të kalojë në Greqi, në Shqipëri, në detin Adriatik deri në Italinë e Jugut.

Prioritet tjetër do të jetë projekti i gazsjellësit “Jon – Adriatik” (IAP), i cili ka lidhje me planet e zhvillimit të rrjetit të gazit natyror në Ballkanin Perëndimor nga Kroacia në Bosnjë-Hercegovinë, në Malin Zi dhe në Shqipëri. Ky projekt shpresohet që të funksionojë në një sistem qarku të mbyllur, ku furnizimi do të realizohet në dy drejtime: Veri-Jug, nga sistemi kroat i

transportit të gazit dhe TAP. Projekti IAP do të jetë gjithashtu pjesë e unazës së gazit të Komitetit të Energjisë, cikli i gazit të Komitetit të Energjisë, i cili është një projekt rajonal i aprovuar nga Komuniteti i Energjisë dhe BE-ja. Projekti i gazsjellësit IAP është aktualisht në fazën e kryerjes së studimit të fizibilitetit me një fond prej 3 milionë eurosh nga BE-ja.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ka pyetje për zotin Sinanaj?

Po, zoti Bici.

Dritan Bici – Në një farë mënyre, nga pikëpamja strategjike TAP-i është një projekt i fuqishëm për të krijuar edhe pavarësinë e Europës nga burimet energjike të Rusisë, personalisht kështu e konceptoj. Qëllimi kryesor është që Europa të ketë furnizimin e vet, por a ka mundësi që ky projekt të konkurrohet me ndonjë projekt paralel nga ana e rusëve?

Mynyr Sinanaj – Ky është një nga projektet më të mëdha, sidomos për Europën Jugore dhe Juglindore. Kjo lidh fushën e Shandenisë, që është fusha më e madhe e naftës, edhe në krahasim me fushat e naftës që ka Rusia. I ka dhënë prioritet edhe qeveria amerikane, me këmbënguljen e së cilës është bërë edhe ky gazsjellës.

(Diskutim pa mikrofon)

Maksim Shuli – Faktikisht, i gjithë prodhimi rus është 150 miliardë në vit, pra 1/3-ta e prodhimit të Europës. Ndërkohë, ky është 20 miliardë si fillim dhe rreth 40 % të kërkesave për Europën, ne e plotësojmë nga të tjerët me gaz të lëngët. Europa ka gjithnjë nevojë.

Një projekt i mundshëm do të ishte “Nord Stream 2”, që diskutohet nga rusët dhe gjermanët, por ai është për pjesën veriore. Ky projekt është si të thuash, politik, dhe fati ynë është që qeveria e mëparshme e pranoi projektin TAP, që sot është *de facto*.

Sot në Itali ende nuk kanë filluar punimet, kjo do të thotë se për ne është një shans shumë i madh, sepse ne vazhdojmë me projektin IAP, domethënë nga Fieri dhe lidhemi me kroatët. Kështu që, pavarësisht llojeve të tubacioneve që ndërtohen nga rusët, ky projekt nuk mund të cenohet, ai është gjigand për ne. Ne bëhemi një nyje dhe gazi vjen qoftë i lëngëzuar dhe futet të rikalcifikohet për t’u futur në tubacion, mjafton të jetë rrjeti.

Niko Peleshi – Atëherë, në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, e mbyllim dëgjuesën.

Raporti që do t’i dërgohet Kuvendit do të paraqesim për votim në seancën plenare.

Urojmë fat për të gjithë kandidatët!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA